



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2024/6 prot.

Datë 02.09.2026

V E N D I M
Nr. 1109/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Gjergj Mersini	Nënkryetar
Donika Daci	Anëtare
Edvin Simo	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.09.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “INERTI Sh.p.k” & “Alges Konstruksion” Sh.p.k.. në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-86499-05-22-2026, me objekt “*Rivitalizim i projektit rruga e Bregdetit, faza 1*”, me fond limit 349,948,682.19 (treqind e dyzet e nëntë milion e nëntëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy pikë nëntëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.

Ankimues:

BOE “INERTI Sh.p.k” me NUIS J66926804L, me adresë: L. SPORTI, , GRAMSH & “Alges Konstruksion” Sh.p.k.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kavajë, me adresë: Bulevardi "Josif Budo", Kavajë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për*

organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”,

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

1.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

1.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.05.2026, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-86499-05-22-2026, me objekt “*Rivitalizim i projektit rruga e Bregdetit, faza 1*”, me fond limit 349,948,682.19 (*treqind e dyzet e nëntë milion e nëntëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy pikë nëntëmbëdhjetë*) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.

II.2. Në datën 09.06.2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 16.06.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. OE “OMERI GROUP” shpk

0

I skualifikuar

- | | |
|---|-------------------------------|
| 2. BOE “ED KONSTRUKSION” shpk & “4 A-M” shpk | 242,573,940 I skualifikuar |
| 3. BOE “INERTI” shpk & “ALGES KONSTRUKSION shpk | 277,531,863.42 I skualifikuar |
| 4. OE “BAMI HOLDING” shpk | 332,417,578.50 I kualifikuar |
| 5. OE “HASTOCI” shpk | 339,367,927.5 I kualifikuar |
| 6. OE “STERKAJ” shpk | 345,554,738 I skualifikuar |

II.4. Në datën 18.06.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim – Fitues paraparak”, për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 40, datë 22.06.2026.

II.5. BOE ankimues “INERTI” shpk & “ALGES KONSTRUKSION shpk, rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyen si më poshtë:

“BOE Inerti shpk dhe “Alges Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 2.3.1 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për të provuar përvojën e mëparshme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës apo punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Operatori ekonomik Inerti shpk ka paraqitur dokumentacion për 4 (katër) kontrata të lidhura me Autoritete Kontraktore të ndryshme.

Konkretisht:

- Ndërtim godinë banimi, shërbimi dhe parkimi
- Rikonstruksion dhe ndërhyrje në linjën KUZ dhe ndërtim I sheshit të parkimit të varrezave publike
- Ndërtimi I urës në lagjen Fezaj, fshati Zall Bastar
- Rehabilitimi emergjent I përroit të Gjerezës tek Fresku

Kontratat e mësipërme nuk kanë natyrë të ngjashme me objektin e prokurimit.”.

II.6. Në datën 24.06.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2024/2026 protokoli, me datë 24.06.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6870 e OE “INERTI Sh.p.k”, për procedurën e prokurimit, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “INERTI” shpk & “ALGES KONSTRUKSION shpk, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 2024/1 prot., datë 25.06.2026, lidhur me arsyet e skualifikimit të BOE “INERTI” shpk

&“ALGES KONSTRUKSION shpk, që kundërshton me anë të ankesës me nr. 2024/2026 prot., datë 24.06.2026.

II.8. Me datë 26.06.2026, OE “INERTI” SHPK ka dërguar me shërbim postar Formular Ankese, të protokolluar me nr. 2024/2 prot., datë 26.06.2026.

II.9. Nëpërmjet shkresës me nr. 2024/3 prot., datë 12.08.2026, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor për dhënie informacioni mbi trajtimin e ankesës së BOE ankimues.

II.10. Nëpërmjet shkresës përcjellëse me nr. 1092/3 prot., datë 21.08.2026, protokolluar me tonën me nr. 1925/5 prot., datë 25.08.2026, me objekt “*Kthim përgjigje*”, dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së BOE ankimues, ku konstatohet, se e ka **refuzuar** atë.

II.11. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e BOE “INERTI” SHPK & “ALGES KONSTRUKSION shpk, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës me arsyen se: “.....“*BOE Inerti shpk dhe “Alges Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 2.3.1 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për të provuar përvojën e mëparshme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës apo punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Operatori ekonomik Inerti shpk ka paraqitur dokumentacion për 4 (katër) kontrata të lidhura me Autoritete Kontraktore të ndryshme.

Konkretisht:

– Ndërtim godinë banimi, shërbimi dhe parkimi

– Rikonstrukcion dhe ndërhyrje në linjën KUZ dhe ndërtim I sheshit të parkimit të varrezave publike

– Ndërtimi I urës në lagjen Fezaj, fshati Zall Bastar

– Rehabilitimi emergjent I përroit të Gjerozës tek Fresku

Kontratat e mësipërme nuk kanë natyrë të ngjashme me objektin e prokurimit.”.....”,
Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika .2.3/ “Kapaciteti teknik”, i dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.
- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të provuar këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- i. Ne rastin e kontratave të ngjashme me sektorin publik të paraqitet:
 1. formularin/formularët e vleresimit, të shoqëruar me aktin/aktet e kolaudimit dhe situacionet përkatëse, sipas shtojcës nr.9;
 2. faturat tatimore perkatëse të deklaruara në organet tatimore;
 3. kontratën/kontratat e zbatimit të punime të ndërtimit;
 4. certifikatën/certifikatat e marrjes në dorezim ose certifikatën/certifikatat e përkohshme të marrjes në dorëzim.

Në rast se kontratat e ngjashme janë lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqiten edhe kontratat e bashkëpunimit midis tyre.

Në rast se kontrata/kontratat e ngjashme janë lidhur në cilësinë e nënkontraktorit, operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin gjithashtu kontratën/kontratat bazë të lidhur me Autoritetin Kontraktor, në të cilën të jenë përfshirë dhe detyrimet e marra përsipër për t'u realizuar nga nënkontraktori.

- ii. Ne rastin e kontratave të ngjashme me sektorin privat të paraqitet:
 1. kontrata/kontratat e sipërmarrjes së zbatimit të punime të ndërtimit;
 2. situacionet;
 3. faturat tatimore perkatëse të deklaruara në organet tatimore;
 4. akti/aktet e kolaudimit;

5. *çertifikatën/çertifikatat e marrjes në dorëzim ose çertifikatën/çertifikatat e përkohshme të marrjes në dorëzim.*

Në rast se kontratat e ngjashme janë lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqiten edhe kontratat e bashkëpunimit midis tyre.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve “a” ose “b” e bën ofertën të kualifikueshme”.

III.1.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, anëtar i BOE, operatori ekonomik “INERTI” SHPK, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

- 1) Kontratë sipërmarrje private me objekt “Dy godina banimi dhe shërbimesh 8 dhe 9 kate me 2 kate parkim nëntokë”, me datë mbarimi të kontratës 29.04.2023, me vlerë të realizuar xxxxxxxx lekë pa tvsh, shoqëruar me kontratë sipërmarrje, me akt-kolaudimi, akt marrje në dorëzim, situacion përfundimtar, formular vlerësimi, fatura tatimore;
- 2) Kontratë me objekt “Rikonstruksion dhe ndërhyrje në linjën KUZ dhe ndërtim i sheshit të parkimit të Varrezave Publike”, e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Bashkia Elbasan dhe subjektit “INERTI” SHPK më datë 07.03.2022, me vlerë xxxxxxxx lekë me Tvsh, shoqëruar me kontrata e punës, situacion përfundimtar, formular vlerësimi, akt marrje në dorëzim, akt kolaudimi.
- 3) Kontratë me objekt “Ndërtim i urës në lagjen Fezaj, fshati Zall Bastar”, e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Bashkia Tiranë dhe subjektit “INERTI” SHPK më datë 08.02.2023, me vlerë xxxxxxxxxxxx lekë me Tvsh, shoqëruar me kontrata e punës, situacion përfundimtar, formular vlerësimi, akt marrje në dorëzim, akt kolaudimi.
- 4) Kontratë me objekt “Rehabilitim emergjent i përroit të Gjerezës tek Fresku”, e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Bashkia Tiranë dhe subjektit “INERTI” SHPK më datë 18.10.2023, me vlerë xxxxxxxx lekë me Tvsh, shoqëruar me kontrata e punës, situacion përfundimtar, formular vlerësimi, akt marrje në dorëzim, akt kolaudimi;

	Kontratat	data e mbarimit të kontrates	Natyra e ngjashme	Vlera realizuar ME-TVSH	Vlera realizuar PA-TVSH
1	Kontratë sipërmarrje private me objekt “Dy godina banimi dhe shërbimesh 8 dhe 9 kate me 2 kate parkim nëntokë”, me datë mbarimi të kontratës 29.04.2023, me vlerë të realizuar xxxxxxxx lekë pa tvsh, shoqëruar me kontratë sipërmarrje, me akt-kolaudimi, akt marrje në dorëzim, situacion përfundimtar, formular vlerësimi, fatura tatimore;	29.04.2023	jo		jo natyre e ngjashme

2	Kontratë me objekt “Rikonstruksion dhe ndërhyrje në linjën KUZ dhe ndërtim i sheshit të parkimit të Varrezave Publike”, e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Bashkia Elbasan dhe subjektit “INERTI” SHPK më datë 07.03.2022, me vlerë xxxxxxxx lekë me Tvsh, shoqëruar me kontrata e punës, situacion përfundimtar, formular vlerësimi, akt marrje në dorëzim, akt kolaudimi	03.12.2022	po	xxxxxxx	xxxxxxx
3	Kontratë me objekt “Ndërtim i urës në lagjen Fezaj, fshati Zall Bastar”, e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Bashkia Tiranë dhe subjektit “INERTI” SHPK më datë 08.02.2023, me vlerë xxxxxxxxxx lekë me Tvsh, shoqëruar me kontrata e punës, situacion përfundimtar, formular vlerësimi, akt marrje në dorëzim, akt kolaudimi	17.10.2023	po	xxxxxxx	xxxxxxx
4	Kontratë me objekt “Rehabilitim emergjent i përroit të Gjerezës tek Fresku”, e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Bashkia Tiranë dhe subjektit “INERTI” SHPK më datë 18.10.2023, me vlerë xxxxxxxx lekë me Tvsh, shoqëruar me kontrata e punës, situacion përfundimtar, formular vlerësimi, akt marrje në dorëzim, akt kolaudimi	05.04.2024	po	xxxxxxx	xxxxxxx
	Fond rezerve te realizuar				xxxxx

Rasti I BOE, INERTI 80%	80%			xxxxxx
Fondi limit I procedures			349,948,682.19	
50%			174,974,341.10	xxxxxx
200%			699,897,364.38	xxxxx

shpallja proc 25.05.2026

5 vite 25.05.2025
25.05.2024
25.05.2023
25.05.2022
25.05.2021

-Kontrata me datë 08.06.2026, për bashkëpunim të përkoshëm të shoqërive tregtare “INERTI” shpk & “ALGES KONSTRUKSION shpk, bashkohen për të realizuar zbatimin e kontrates

me objekt prokurimi: “Rivitalizim i projektit Rruga e Bregdetit, faza 1”. Keto shoqeri krijojne kete bashkim te perkohshem ndermjet tyre, pikerisht me qellimin per te permbushur dhe finalizuar kapacitetet e kerkuara nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Kavaje lidhur me realizimin e Kontrates. Në nenin 2 të saj, pika 2. Pjesëmarrja e paleve e shprehur ne përqindje si per investimin ne arritjen e objektit te kësaj kontrate dhe ndarjen e fitimit te jete konkretisht:

INERTI sh.p.k do te këtë një pjesëmarrje 80 %

ALGES KONSTRUKSION shpk do te këtë një pjesëmarrje 20 %

III.1.3. Në nenin 77, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.1.4. Në nenin 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Sqarojmë, se referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat për punë publike, për të provuar përvojën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë njërën prej dy kushteve të përcaktuara në nenin 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar*, ku operatori ekonomik duhet të provojë, se ka kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose të provojë se ka kryer punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga BOE ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit, për punime të ngjashme gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, anëtar i BOE ankimues ka paraqitur dokumentacionin e cituar në pikën III.1.2. Nisur nga arsyeja e skualifikimit të dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave se ... *Kontratat e mësipërme nuk kanë natyrë të ngjashme me objektin e prokurimit.....* si dhe nga krahasimi i kontratave të dorëzuara nga ky subjekt (anëtar i BOE ankimues), situacioneve përfundimtare të punimeve në zbatim të kontratave të sipërcituara të realizuara prej tij, faturave tatimore të shitjes, me preventivin, dhe relacionin e specifikimeve teknike të objektit të prokurimit, të dhëna këto në dokumentet e tenderit objekt-prokurimi, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmive të

eksperiencës së ngjashme, të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimes, parë kjo në rrafshin krahasimor me preventivin dhe relacionin e specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor, për sa i përket komponentit natyrë e ngjashme (*i cili lidhet me natyrën e ngjashme të kontratave të dorëzuara nga bashkimi i operatorëve ekonomikë me objektin e prokurimit nisur jo vetëm nga emërtesa e kontratës por edhe nga zërat e preventivave të tyre*). Komisioni konstaton, se arsyeja e skualifikimit të BOE ankimes lidhet me ngjashmërinë e objektit të punimeve të kontratave të realizuara nga anëtari i BOE, konkretisht operatori ekonomik “INERTI” shpk. Referuar arsyes së skualifikimit, si dhe referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, shtojcës nr. 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, si dhe preventivit të punimeve të ngarkuar në SPE Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentin e ngarkuar në SPE “Preventiv punimesh”, punimet që janë parashikuar për tu realizuar, si vijon ndër to: “.....Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet, Transport dheu me auto deri 5.0 km, Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri, Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur e ngjeshur me makineri, Shtrese stabilizant t=20cm, Shtrese konglomerati t=10cm, Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur e ngjeshur me makineri , Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makiner, Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri , Ndertim Pusete kontrolli Elektrotelefoni, me kapak gize, 1.0x1.0x1.0 m, Prishje struktura prej betoni , Struktura monolite betoni C 20/25, F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm, Pusete shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize, . Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 200 cm, F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=500 mm, F.V. Kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement , F.V. Tabela trekendore normal me A = 90, F.V. Sinjalet e drejtimit urban HxL normal 25x125, Spostim shtylle elektrike (Cmontim dhe montim shtylle elektrike prej betoni perfshire linjat dhe aksesoret) , F.V. Bordura guri 12x25cm, perfshi betonin per fiksim , F.V Pllake Guri per kuneta, Heqje pemesh ekzistuese”. Referuar relacionit teknik dhe specifikimeve teknike, projekti synon realizimin e Rivitalizim i projektit rruga e Bregdetit, faza 1. Ne projekt zbatimi eshte parashikuar ndertimi i rruges kryesore me gjatesi 1377ml, neper te cilen do te kaloje trafiku i zones perreth. Gjate zgjidhjes se dhene teknike eshte patur ne konsiderate ndertimi i nje segmenti rrugor i cili te sherbeje per perballimin e levizjeve ne kete zone, duke u pershtatur me pozicionet planimetrike te objekteve qe e konturojne. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga anëtari i BOE ankimes, “Inerti” shpk, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE), KPP vëren, se operatori ekonomik Inerti shpk në përmbushje të kriterit kualifikues lidhur me punimet e mëparshme të ngjashme (pika 2.3.1e DST), të kryera gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës OE ankimes ka dorëzuar dokumentacionin e listuar në pikën III.1.2. të këtij vendimi. Referuar dokumentacionit të sipërpërmendur, si dhe nisur nga arsyeja e skualifikimit të argumentuar nga ana e Komisionit të Vlerësimit të ofertave, se subjekti INERTI Shpk nuk e përmbushë këtë pikë pasi nuk ka realizuar punë të ngjashme në lidhje me objektin e prokurimit, Komisioni konstaton, se referuar kontratave të dorëzuara me dokumentacionin e tyre shoqërues, nga BOE ankimes, konkretisht anëtari i BOE, Inerti shpk, në SPE, konkretisht ato me objekt si:

- 1) Kontratë me objekt *“Rikonstruksion dhe ndërhyrje në linjën KUZ dhe ndërtim i sheshit të parkimit të Varrezave Publike”*, e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Bashkia Elbasan dhe subjektit *“INERTI” SHPK* më datë 07.03.2022, me vlerë xxxxx lekë me Tvsh, shoqëruar me kontrata e punës, situacion përfundimtar, formular vlerësimi, akt marrje në dorëzim, akt kolaudimi.
- 2) Kontratë me objekt *“Ndërtim i urës në lagjen Fezaj, fshati Zall Bastar”*, e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Bashkia Tiranë dhe subjektit *“INERTI” SHPK* më datë 08.02.2023, me vlerë xxxxx lekë me Tvsh, shoqëruar me kontrata e punës, situacion përfundimtar, formular vlerësimi, akt marrje në dorëzim, akt kolaudimi.
- 3) Kontratë me objekt *“Rehabilitim emergjent i përroit të Gjerezës tek Fresku”*, e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Bashkia Tiranë dhe subjektit *“INERTI” SHPK* më datë 18.10.2023, me vlerë xxxxxx lekë me Tvsh, shoqëruar me kontrata e punës, situacion përfundimtar, formular vlerësimi, akt marrje në dorëzim, akt kolaudimi;

rezulton se, anëtari i BOE ankimes, operatori ekonomik *“INERTI” shpk* ka kryer punime si vijon: *“gërmim dhe me eskavator zinxhir, ndërtim puseta betoni, shtresë stabilizanti, shtresë binderi, shtresë asfaltbetoni, puseta elektrike, f.v. ndricues, punime sinjalistike, mbjellje bari, fv puseta kontrolli, transport dheu me auto deri 5 km,. Gërmim dheu me eskavator zinxhir 1.0m3, në kanale gjerësi > 2m, tok, zak, kategoria IV, me shk në mjet, ndërtim kasonete në tokë mesatare, FV hekur betoni peroidik dim >12mm jastëk, prishje shtresa betoni, FV kesone betoni arme 2x2 m, h=2, L=2m, Fv, gjeotekstil, ...e tjerë.. Referuar kontratave të sipërcituara, situacioneve përfundimtare si dhe faturave të dorëzuara në SPE, dhe konkretisht referuar punimeve të kryera nga anëtari i BOE ankimes, konkretisht operatori ekonomik *“INERTI” SHPK*, si dhe preventivit dhe relacionit teknik të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni gjykon se, tre kontratat e sipërcituara nga operatori ekonomik *“INERTI” SHPK* kanë si objekt: *“.....Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjerësi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet, Transport dheu me auto deri 5.0 km, Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri, Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur e ngjeshur me makineri, Shtrese stabilizant t=20cm, Shtrese konglomerati t=10cm, Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur e ngjeshur me makineri , Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makiner, Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri , Nderim Pusete kontrolli Elektrotelefoni, me kapak gize, 1.0x1.0x1.0 m, Prishje struktura prej betoni , Struktura monolite betoni C 20/25, F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm, Pusete shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize, . Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 200 cm, F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=500 mm, F.V. Kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement , F.V. Tabela trekendore normal me A = 90, F.V. Sinjalet e drejtimit urban HxL normal 25x125, Spostim shtylle elektrike (Cmontim dhe montim shtylle elektrike prej betoni perfshire linjat dhe aksesoret) , F.V. Bordura guri 12x25cm, perfshi betonin per fiksim , F.V Pllake Guri per kuneta, Heqje pemesh ekzistuese”*. Për rrjedhojë, tre kontratat e sipërcituara, përbëjnë punë të ngjashme, në kuptim të pikës 2.3.1 të Kriterëve të veçanta të kualifikimit.*

Ndërsa, në lidhje me kontratën me sipërmarrje private me objekt *“Dy godina banimi dhe shërbimesh 8 dhe 9 kate me 2 kate parkim nëntokë”*, me datë mbarimi të kontratës 29.04.2023, me vlerë të realizuar xxxxxxxxxxxx lekë pa tvsh, shoqëruar me kontratë

sipërmarrje, me akt-kolaudimi, akt marrje në dorëzim, situacion përfundimtar, formular vlerësimi, fatura tatimore, Komisioni gjykon se, nuk përbën kontratë me natyrë të ngjashme me objektin e procedurës objekt ankimi.

Gjithashtu, referuar edhe pikës 3, të nenit 88 të VKM nr.285, më datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ***Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.***

Sa më sipër, referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket eksperiencës së ngjashme, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Inerti” SHPK & “ALGES KONSTRUKSION” SHPK, konstatojmë, se referuar kontratës së bashkëpunimit më datë 08.06.2026, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, ku në nenin 2 “Elementët e bashkëpunimit”, përcaktohet, konkretisht, citojmë: “.....pika.2. Pjesëmarrja e paleve e shprehur në përqindje si për investimin në arritjen e objektit të kësaj kontrate dhe ndarjen e fitimit të jete konkretisht:

INERTI sh.p.k do të ketë një pjesëmarrje 80 %

ALGES KONSTRUKSION shpk do të ketë një pjesëmarrje 20 %

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga anëtari Inerti shpk, i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Inerti” SHPK & “ALGES KONSTRUKSION” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky bashkim operatorësh ekonomik i krijuar me kontratën e bashkëpunimit të datës 08.06.2026, ka paraqitur ofertë në këtë procedurë prokurimi, ku përfaqësues i këtij bashkimi rezulton të jetë shoqëria “Inerti” SHPK. Për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit, për punime të ngjashme gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, anëtari Inerti shpk i bashkimit të operatorëve ekonomikë ka paraqitur dokumentacionin e cituar në pikën III.1.2.

Nga krahasimi i kontratave të dorëzuara nga ky anëtar i këtij bashkimi operatorësh, situacioneve përfundimtare të punimeve në zbatim të kontratave të sipërcituara, faturave tatimore të shitjes, me preventivin, dhe relacionit të specifikimeve teknike të objektit të prokurimit, të dhëna këto në dokumentet e tenderit objekt-prokurimi, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmimeve të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e anëtarit të bashkimit të operatorëve ekonomike “Inerti” SHPK & “ALGES KONSTRUKSION” SHPK, konkretisht “Inerti” shpk, parë kjo në rrafshin krahasimor me preventivin dhe relacionin e specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor, për sa i përket 3 komponentëve, si komponenti **kohë** (ku Komisioni për këtë komponentë do të marrë në konsideratë ato kontrata të cilat janë brenda afatit kohorë 5 vjeçar nga data e njoftimit të kontratës), komponenti **vlerë** (lidhet me madhësinë e kontratës ose kontratave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.1 a.punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të

madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.
b.punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për punë publike ligjvënësi në nenin 39, pika 5 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë ose me sektorin privat me paraqitjen e vërtetimeve të shoqëruar dhe me fatura tatimore ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, me një vlerë jo më të madhe se 50 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërimit të dokumentacionit është brenda periudhës pesë vjeçare sikundër parashikohet edhe në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave. Në nenin 14, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, është parashikuar e drejta e operatorëve ekonomikë që të paraqesin oferta në procedurat e prokurimit në formën e grupeve të operatorëve ekonomikë, ndërkohë që në nenin 88 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar detyrimi që këto grupe operatorësh ekonomikë duhet të krijohen nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi, ku të përcaktojnë qartë zërat konkret të shërbimit apo punimit apo furnizimit me mall që merr përsipër secili prej anëtarëve të këtij grupi dhe përqindjen e bashkëpunimit, si dhe kërkesat për kualifikim të natyrës ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. KPP verifikoi dokumentacionin e dorëzuar në SPE nga anëtari i BOE, operatori ekonomik “**Inerti**” SHPK për plotësimin e kushtit të parë “*punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim*”.

KPP nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të kontratave të sipërcituara, duke nisur që nga objekti i tyre, vërtetimi i realizimit (si dokument i përcaktuar në kriter për vërtetueshmërinë e punëve të ngjashme), përshkrimi i punimeve në situacion apo faturë tatimore si pjesë përbërëse e kontratave, si dhe afatit të realizimit të tyre, nga të gjitha kontratat e dorëzuara në sistemin e prokurimeve elektronike nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë **“Inerti” SHPK** për vërtetueshmërinë e përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1/a të dokumenteve standarde të tenderit, mori në shqyrtim kontratat të ngarkuar në PDF në sistemin e prokurimit elektronik, si më poshtë:

- 1) Kontratë me objekt *“Rikonstrukcion dhe ndërhyrje në linjën KUZ dhe ndërtim i sheshit të parkimit të Varrezave Publike”*, e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Bashkia Elbasan dhe subjektit **“INERTI” SHPK** më datë 07.03.2022, me vlerë xxxxxx lekë me Tvsh, shoqëruar me kontrata e punës, situacion përfundimtar, formular vlerësimi, akt marrje në dorëzim, akt kolaudimi.
- 2) Kontratë me objekt *“Ndërtim i urës në lagjen Fezaj, fshati Zall Bastar”*, e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Bashkia Tiranë dhe subjektit **“INERTI” SHPK** më datë 08.02.2023, me vlerë xxxxxxxx lekë me Tvsh, shoqëruar me kontrata e punës, situacion përfundimtar, formular vlerësimi, akt marrje në dorëzim, akt kolaudimi.
- 3) Kontratë me objekt *“Rehabilitim emergjent i përroit të Gjerezës tek Fresku”*, e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Bashkia Tiranë dhe subjektit **“INERTI” SHPK** më datë 18.10.2023, me vlerë xxxxxxxx lekë me Tvsh, shoqëruar me kontrata e punës, situacion përfundimtar, formular vlerësimi, akt marrje në dorëzim, akt kolaudimi;

Komisioni i Prokurimit Publik do të marrë në shqyrtim në themel kontratat e sipërcituara, pasi këto kontrata i përmbushin të tre komponentët, pra si komponentin vlefshmëri (që janë brenda afatit pesëvjeçar), si komponentin ngjashmëri (që kanë objekt apo zëra të ngjashëm në situacion dhe fatura si zërat në preventivin e objektit të prokurimit) dhe si komponentin e vlerës së realizuar. Komisioni i Prokurimit Publik, pasi veçoi kontratat e sipërcituara, të cilat i përmbushin të tre komponentët që karakterizojnë një kontratë të ngjashme, pra elementin kohë, elementin vlerë dhe elementin ngjashmëri, vëren se, nga përlllogaritja e kontratave, situacionet dhe faturat e paraqitura nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë, konkretisht **“Inerti” SHPK**, rezulton se referuar përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit nga operatori ekonomik **“Inerti” SHPK** 80 % ose $80\% \cdot 50\% \cdot 349,948,682.19 = 139,979,472.88$ lekë PA TVSH. Sa më sipër, nga përlllogaritjet e kryera nga Komisioni për asnjë nga kontratat e ngjashme të marrë në shqyrtim nuk rezulton, se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë **“Inerti” SHPK**, sipas përqindjes së pjesëmarrjes së këtij të fundit në marrëveshjen e bashkëpunimit të përkohshme midis **“Inerti” SHPK & “ALGES KONSTRUKSION” SHPK**, nuk arrin vlerën prej 139,979,472.88 lekë pa TVSH që duhet të plotësonte ky operator në varësi të përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit, duke mos e përmbushur kriterin në lidhje me eksperiencën e ngjashme, në vlerën e kërkuar në kriteret e kualifikimit 2.3.1/a . Rrjedhimisht ky kriter nuk do të konsiderohet i përmbushur nga anëtari i bashkimit operatori ekonomik **“Inerti” SHPK**.

Për këtë arsye, Komisioni iu referua për plotësimin e kushtit të dytë *“punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim”*. KPP nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të kontratave të sipërcituara, duke nisur që nga objekti i tyre, vërtetimi i realizimit (si dokument i përcaktuar në kriter për vërtetueshmërinë e punëve të ngjashme), përshkrimi i punimeve në situacion apo faturë tatimore si pjesë përbërëse e kontratave, si dhe afatit të realizimit të tyre, nga të gjitha kontratat e dorëzuara në sistemin e prokurimeve elektronike nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë **“Inerti”** SHPK për vërtetueshmërinë e përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1/b të dokumenteve standarde të tenderit, mori në shqyrtim kontratat të ngarkuar në PDF në sistemin e prokurimit elektronik, si më poshtë:

- 1) Kontratë me objekt *“Rikonstruksion dhe ndërhyrje në linjën KUZ dhe ndërtim i sheshit të parkimit të Varrezave Publike”*, e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Bashkia Elbasan dhe subjektit **“INERTI”** SHPK më datë 07.03.2022, me vlerë xxxxxxxx lekë me Tvsh, shoqëruar me kontrata e punës, situacion përfundimtar, formular vlerësimi, akt marrje në dorëzim, akt kolaudimi.
- 2) Kontratë me objekt *“Ndërtim i urës në lagjen Fezaj, fshati Zall Bastar”*, e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Bashkia Tiranë dhe subjektit **“INERTI”** SHPK më datë 08.02.2023, me vlerë xxxxxxxx lekë me Tvsh, shoqëruar me kontrata e punës, situacion përfundimtar, formular vlerësimi, akt marrje në dorëzim, akt kolaudimi.
- 3) Kontratë me objekt *“Rehabilitim emergjent i përroit të Gjerozës tek Fresku”*, e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Bashkia Tiranë dhe subjektit **“INERTI”** SHPK më datë 18.10.2023, me vlerë xxxxxx lekë me Tvsh, shoqëruar me kontrata e punës, situacion përfundimtar, formular vlerësimi, akt marrje në dorëzim, akt kolaudimi;

Komisioni i Prokurimit Publik do të marrë në shqyrtim në themel kontratat e sipërcituara, pasi këto kontrata i përmbushin të tre komponentët, pra si komponentin vlefshmëri (që janë brenda afatit pesëvjeçar), si komponentin ngjashmëri (që kanë objekt apo zëra të ngjashëm në situacion dhe fatura si zërat në preventivin e objektit të prokurimit) dhe si komponentin e vlerës së realizuar. Komisioni i Prokurimit Publik, pasi veçoi kontratat e sipërcituara, të cilat i përmbushin të tre komponentët që karakterizojnë një kontratë të ngjashme, pra elementin kohë, elementin vlerë dhe elementin ngjashmëri, vëren se, nga përllogaritja e kontratave, situacionet dhe faturat e paraqitura nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë, konkretisht **“Inerti”** SHPK, rezulton se janë në vlerën xxxxxxxx lekë PA TVSH, ndërkohë që në kriterin e kualifikimit kërkohet 2.3.1/b *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim*, dhe referuar përqindjes së

marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit nga operatori ekonomik "Inerti" SHPK 80 % ose $80\% \cdot 200\% \cdot 349,948,682.19 = 559,917,891.50$ lekë PA TVSH.

Sa më sipër, nga përlllogaritjet e kryera nga Komisioni për kontratat e ngjashme të marra në shqyrtim rezulton, se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë "Inerti" SHPK, sipas përqindjes së pjesëmarrjes së këtij të fundit në secilën prej kontratave të paraqitura, vlen të theksohet, se vlera e përgjithshme e punimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga ky operator ekonomik është xxxxxxxx lekë PA TVSH, duke mos e kaluar vlerën prej 559,917,891.50 lekë pa TVSH që duhet të plotësohet ky operator në varësi të përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit, duke mos e përmbushur kriterin në lidhje me eksperiencën e ngjashme, në vlerën e kërkuar në kriteret e kualifikimit 2.3.1/b *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.* Rrjedhimisht ky kriter nuk do të konsiderohet i përmbushur nga anëtari i bashkimit operatori ekonomik "Inerti" SHPK.

KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Gjithashtu, nga përlllogaritja e vlerës së punëve të ngjashme të paraqitura nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë "Inerti" SHPK, duke e përlllogaritur sipas përqindjes së pjesëmarrjes së këtij të fundit në kontratat e paraqitura, vlen të theksohet, se vlera e përgjithshme e punimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga ky operator ekonomik "Inerti" SHPK është xxxxxxxx lekë PA TVSH, nuk arrin të kalojë vlerën prej 559,917,891.50 lekë pa TVSH, të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, në përputhje me përqindjen prej 80% sipas marrëveshjes së përkoshmë të bashkimit të operatorëve ekonomikë në datën 08.06.2026.

Nga verifikimi i zërave dhe volumeve të ngjashme të preventivit të kontratave të paraqitura nga ankimuesi si eksperiencia të ngjashme të mëparshme, nga përlllogaritja e zërave të ngjashëm për sa i përket llojit, tipologjisë, emërimit/përshkrimit, me zërat e preventivit të kontratës objekt shqyrtimi, rezulton se operatori ekonomik ankimues ka arritur të dëshmojë se ka kryer kontrata të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit por nuk ka arritur të dëshmojë këtë realizim duke arritur në vlerën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi dokumentacioni i dorëzuar në pikën III.1.2, arrin në vlerën prej xxxxxxxx lekë PA TVSH, dhe jo sipas kërkesës së pikës 2.3.1/b të autoritetit kontraktor të

përbushit vlerën prej 559,917,891.50 lekë pa TVSH, në bazë të përqindjes së pjesëmarrjes së këtij të fundit në kontratën e paraqitur.

III.1.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për eksperiencën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, anëtarit i BOE *“Inerti” SHPK & “ALGES KONSTRUKSION” SHPK*, konkretisht operatori ekonomik *“Inerti” SHPK* nuk arrin të vërtetojë se plotëson kriterin 2.3.1/b të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit, në bazë të përqindjes së pjesëmarrjes së këtij të fundit në kontratën e paraqitur.

Rrjedhimisht, pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e BOE ankimues *“INERTI” shpk & “ALGES KONSTRUKSION shpk* për procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur”*, me Nr. REF-86499-05-22-2026, me objekt *“Rivitalizim i projektit rruga e Bregdetit, faza 1”*, me fond limit 349,948,682.19 (treqind e dyzet e nëntë milion e nëntëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy pikë nëntëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. Ngarkohet zyra e financës që të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare nga BOE “INERTI” shpk & “ALGES KONSTRUKSION shpk.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Gjergj Mersini

Anëtare
Donika Daci

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Nertil Kanina

Kryetar
Ismail Shehu



Vulosur elektronikisht nga Komisioni i Prokurimit Publik
Date: 2026/09/03 15:32:11 +02'00"
198e44664bfc4d42ab9b2301b9453e622026090315320
998020

Digitally signed by
Ismail Shehu
Date: 2026.09.03
03:58:59